



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1222/10 prot.

Datë 26.05.2025

V E N D I M

Nr. 702/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fioorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GJIKURIA” Sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-35009-12-31-2024 me objekt “*Ndërtim Shkollë 9 vjeçare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4), Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët”, Tiranë*”, me fond limit 694,106,416.04 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë pikë zero katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE

“NOVA CONSTRUCTION GROUP” Shpk në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “NG STRUCTURES” Sh.p.k” & “G.P.G. COMPANY” Shpk në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), me NUIS J67902928O, me adresë: Tiranë, Njësia bashkiake nr. 5, Rruga Zef Jubani, ndërtesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, & “ASI-2A CO” Shpk me NUIS K53002402C.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tiranë, me adresë: Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “GJIKURIA” Sh.p.k, me NUIS J62903456H, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Faik Konica”, Residenza “Lion Park”, kati 3-të, Tiranë.

BOE “NG STRUCTURES Sh.p.k” (përfaqësues), me NUIS L79326502O, me adresë: Tepelenë, Gjirokastrë, Lagjja "Selam Musai", Rruga Dule Dalani, Nr. pasurie 14/324, Zona Kadastrale 3574, Kati i dyte & “G.P.G. COMPANY” Shpk.

Operatori ekonomik “NOVA CONSTRUCTION GROUP” Sh.p.k, me NUIS L22404012D, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga “Kajo Karafili”, Nr. Pasure 2/423-N37, Zona kadastrale 8380, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.01.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35009-12-31-2024 me objekt “Ndërtim Shkollë 9 vjeçare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4), Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët”, Tiranë”, me fond limit 694,106,416.04 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë pikë zero katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën, 05.02.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datën 28.03.2025 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “FRONTIER CONSTRUCTION” shpk 0 lekë I skualifikuar
2. “SENKA” sh.p.k 0 lekë I skualifikuar
3. BOE “NG STRUCTURES” sh.p.k & “G.P.G COMPANY” shpk 431,540,207.00 lekë
4. “Nova Construction Group” sh.p.k 444,446,397.68 I kualifikuar
5. BOE “L.T.E Construction” sh.p.k & “B93 II” sh.p.k & “ZEQILLARI” sh.p.k & “BEQIRI” sh.p.k & “INFINIT” shpk 444,907,075.65 I skualifikuar
6. BOE “KUPA” sh.p.k & “NEAL-86” sh.p.k & “HTM” sh.p.k & “STERKAJ” shpk 468,165,620.74 I skualifikuar
7. BOE “BAJRAMI N.” sh.p.k & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k 468,538,773.31 I skualifikuar
8. “GJIKURIA” sh.p.k 491,510,572.30 I kualifikuar
9. BOE “S I R E T A 2F” sh.p.k & “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k & “ALKO-IMPEX General Construction” sh.p.k 491,936,300.00 I skualifikuar
10. BOE “RSM COMPANY” sh.p.k & “Eurovia DOOEL” sh.p.k & “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k 501,251,200.00 I skualifikuar
11. “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k & “EVEREST” sh.p.k & “A.L-ASFALT” sh.p.k 504,493,127.95 I skualifikuar
12. “ULZA” sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k 510,866,309.92 I kualifikuar
13. “4 A-M” sh.p.k 513,789,820.86 I kualifikuar
14. “INERTI” sh.p.k & “ADMC Internacional” sh.p.k 518,786,226.72 I skualifikuar
15. BOE “LLAZO” sh.p.k & “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k & “VIBTIS” sh.p.k 520,591,151.75 I skualifikuar
16. BOE “ED KONSTRUKSION” sh.p.k & “FUSHA” sh.p.k 528,654,533.50 lekë I kualifikuar
17. “DION-AL” sh.p.k & “ARKONSTUDIO” sh.p.k 553,072,941.21 lekë I skualifikuar
18. BOE “Z D R A V A” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k 566,992,362.37 lekë I skualifikuar
19. “CURRI” sh.p.k 581,558,424.45 lekë I skualifikuar
20. “BE – IS” sh.p.k & “2 T” sh.p.k 582,458,919.00 lekë I kualifikuar
21. “ERGI” sh.p.k 582,733,527.00 lekë I skualifikuar
22. BOE “RAFIN COMPANY” sh.p.k & “NDREGJONI” sh.p.k 614,049,079.00 lekë I kualifikuar
23. BOE “LIQENI VII” sh.p.k & “KTHELLA” sh.p.k & “SARDO” sh.p.k 614,393,619.38 lekë I skualifikuar
24. BOE “AGI KONS” sh.p.k & “C O L O M B O” sh.p.k 618,353,416.46 lekë I skualifikuar
25. “ALBA KONSTRUKSION” sh.p.k 623,307,561.00 lekë I kualifikuar
26. “PE - VLA - KU” sh.p.k 624,225,437.28 lekë I kualifikuar

27. “SALILLARI” sh.p.k 659,000,000.00 lekë I kualifikuar

II.4. Në datën 02.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, publikuar në Buletinin e Njftimeve Publike nr. 23, datë 05.05.2025, ku është shpallur fitues BOE “NG STRUCTURES” sh.p.k & “G.P.G COMPANY”.

II.5. Në datën 12.05.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1222/2025 protokolli, me datë 12.05.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5304 e BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë: “GJIKURIA” Sh.p.k, “NOVA CONSTRUCTION GROUP” Shpk dhe BOE “NG STRUCTURES” Sh.p.k” & “G.P.G. COMPANY” Shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1222/1 prot, datë 13.05.2025, lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë: “GJIKURIA” Sh.p.k, “NOVA CONSTRUCTION GROUP” Shpk dhe BOE “NG STRUCTURES” Sh.p.k” & “G.P.G. COMPANY” Shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër 1222/2025 datë 12.05.2025 rezulton **“Papaqitur mandat pagesë”**. Me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP me shkresën nr. 1222/3 prot., datë 19.05.2025 nga KPP ju kërkua informacion autoritetit kontraktor për sa më poshtë vijon:

... me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e të metave të ankesës ...”.

II.8. Me shkresën nr. 1222/4 prot., datë 19.05.2025 lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, Sekori i Financës informon ndër të tjera se: “ [...] ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 1222/2025 prot., datë 12.05.2025 , me numër ankimi elektronik A/2025/5304, BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar që vërteton kryerjen e pagesës për ankimin në Komisionin e Prokurimit Publik ...

II.9. Nëpërmjet komunikimit të postës elektronike, me shkresën nr. 18615/1 prot., datë 21.05.2025, protokolluar me tonën me nr.1222/5 prot., datë 22.05.2025, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se: “[...].....autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë më datë 14.05.2025, njoftoi nëpërmjet email zyrtar BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, për plotësimin e elementëve të ankesës..... Sa më sipër, ju informojmë se ankesa vazhdon të qëndrojë me statusin “pa paguar” dhe për këtë arsye u konsiderua e paparaqitur dhe nuk u trajtua nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) pasi edhe pas njoftimit të autoritetit kontraktor, BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, nuk ka bërë korrigjimet përkatëse në lidhje me pagesën e tarifës [...]”.

II.10. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 18615/1 prot., datë 21.05.2025, protokolluar me tonën me nr.1222/6 prot., datë 23.05.2025, autoriteti kontraktor informon Komisionin e prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se: “[...].....autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë më datë 14.05.2025, njoftoi nëpërmjet email zyrtar BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, për plotësimin e elementëve të ankesës..... Sa më sipër, ju informojmë se ankesa vazhdon të qëndrojë me statusin “pa paguar” dhe për këtë arsye u konsiderua e paparaqitur dhe nuk u trajtua nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) pasi edhe pas njoftimit të autoritetit kontraktor, BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, nuk ka bërë korrigjimet përkatëse në lidhje me pagesën e tarifës [...]”.

II.11. Nëpërmjet komunikimit të postës elektronike, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, duke dërguar edhe dokumentacion provues bashkëlidhur email:

-Proceverbal i dates 21.05.2025 mbajtur nga Konisioni i Shqyrtimit te Ankesave

-Njoftim email derguar ankimuesit

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 12.05.2025 nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave nga BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, me nr. ankimi elektronik A/2025/5304, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-35009-12-31-2024 me objekt “*Ndërtim Shkollë 9 vjeçare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4), Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët”, Tiranë*”, me fond limit 694,106,416.04 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë pikë zero katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë: “GJIKURIA” Sh.p.k, “NOVA CONSTRUCTION GROUP” Shpk dhe BOE “NG STRUCTURES” Sh.p.k & “G.P.G. COMPANY” Shpk, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se BOE ankimues “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Me shkresën nr. 18615/1 prot., datë 21.05.2025, protokolluar me tonën me nr.1222/5 prot., datë 22.05.2025, autoriteti kontraktor informon Komisionin e prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se: “[...].....autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë më datë 14.05.2025, njoftoi nëpërmjet email zyrtar BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, për plotësimin e elementëve të ankesës..... Sa më sipër, ju informojmë se ankesa vazhdon të qëndrojë me statusin “pa paguar” dhe për këtë arsye u konsiderua e paparaqitur dhe nuk u trajtua nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) pasi edhe pas njoftimit të autoritetit kontraktor, BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, nuk ka bërë korrigjimet përkatëse në lidhje me pagesën e tarifës [...]”.

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendim marrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr. 18615/1 prot., datë 21.05.2025, protokolluar me tonën me nr.1222/5 prot., datë 22.05.2025 rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit elektronik i ka kërkuar BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP,

janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (më datë 14.05.2025) bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues përmes komunikimit elektronik, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës. Gjithashtu, me shkresën nr. 1222/4 prot., datë 19.05.2025 lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, Sekori i Financës informon ndër të tjera se: “ [...] ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 1222/2025 prot., datë 12.05.2025 , me numër ankimi elektronik A/2025/5304, BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar që vërteton kryerjen e pagesës për ankimin në Komisionin e Prokurimit Publik ...

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, **rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “ULZA” SHPK (përfaqësues), & “S ASI-2A CO” Shpk, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35009-12-31-2024 me objekt “Ndërtim Shkollë 9 vjeçare Tipi (2) dhe e mesme Tipi (4), Njësia Strukturore KA 283, Rruga “3 Dëshmorët”, Tiranë”, me fond limit 694,106,416.04 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e gjashtë

mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë pikë zero katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

